

NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË **KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË** **SAJ**

SPITALI RAJONAL SHKODËR

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË
ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri:	Spitali Rajonal Shkoder
Adresa:	Rruga Kole Heqimi, Shkoder
Tel/Faks:	069 7691088
E-mail:	spitalishkoder@shendetesia.gov.al redonahaxhijaj1@hotmail.com
Adresa e ueb-fages:	ëëë.spitalirajonalshkoder.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Nermin Gjyrezi
E-mail Nermingjyrezi@gmail.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: ‘ E hapur’

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: Marrëveshje kuadër me disa operatore ekonomik (një operator ekonomik per secilin lot), me afat 12 muaj, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin REF 30011-11-19-2024
Lot 2 REF 30025-11-19-2024

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër : Trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore e ndare ne lote
Lot 2 “Trajtim dhe asgjësimin i mbetjeve te rrezikshme”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore 90524400-0

8. Fondi limit: me fond total limit:13,051,463.00(trembedhjetemilion e pesedhete e njëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH

Lot 2 me fond limit: 11,352,000 (njembedhete e njemilion e treqind e pesedhete e dymije) lekë pa tvsh.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Modifikimi i kontratës nr. Nr. 673 Prot., Datë 17.03.2025 bazohet në nenin 127 pika 1 përcakton [...] Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re

prokurimi në rastet e mëposhtme: c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër. [...]

2. Në rastet e referuara në pikën 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të këtij neni, vlera totale e modifikimeve të kontratës apo marrëveshjes kuadër nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. . [...]

Procedura e prokurimit me objekt: “Trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore e ndare ne lote Lot 2 “Trajtim dhe asgjësimin i mbetjeve te rrezikshme” me afat 12 muaj , është dërguar për prokurim pranë OBP me anë të shkresës nr. 39 Prot., datë 08.01.2026

OBP ka dërguar faturën e shërbimit per kryerjen e procedurës me date 27.01.2025. Autoriteti Kontraktor e ka kryer pagesën po me ate date. Mbetimi ne pritje të hedhjes se procedurës nga ana e OBP-së.

Autoriteti Kontraktor ka lidhur Marrëveshje Kuadër për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, bazuar në vlerësimin paraprak të sasive të prodhuara nga institucionet përfituese gjatë periudhës 12-mujore.Gjatë zbatimit të kontratës është konstatuar se sasia e planifikuar e mbetjeve të rrezikshme është realizuar përpara përfundimit të afatit kontraktual(brenda 9 muajve), si pasojë e rritjes reale të volumit të mbetjeve të prodhuara.

Rritja e sasive të mbetjeve të rrezikshme ka ardhur si rezultat i rritjes së aktivitetit të spitalit,shtimit të ndërhyrjeve mjekësore dhe procedurave diagnostike,përdorimit të shtuar të materialeve njëpërdorimëshe dhe produkteve mjekësore që klasifikohen si mbetje të rrezikshme.

Këto rrethana nuk kanë qenë objektivist të parashikueshme në momentin e planifikimit të kontratës,nuk lidhen me planifikim të gabuar apo keqmenaxhim,janë të dokumentuara përmes raporteve mujore të prodhimit të mbetjeve nga shërbimet përkatëse.

Mbetjet e rrezikshme janë infektive, toksike ose biologjikisht aktive,nuk mund të magazinohen përtej afateve teknike dhe sanitare,kërkojnë evadim periodik dhe të kontrolluar.

Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme përbën detyrim ligjor dhe mjedisor për Autoritetin Kontraktor .Çdo ndërprerje e shërbimit krijon rrezik epidemiologjik,rrezikon përhapje infeksioneshsi dhe cenon drejtpërdrejt sigurinë sanitare.

Mosrealizimi i këtij shërbimi do të sillte,rrezik serioz për pacientin.Shtesa e kontratës është e domosdoshme për garantimin e sigurisë shëndetësore,mbrojtjes së mjedisit,funksionimit normal të institucionit.Zhvillimi i një procedure të re prokurimi kërkon afate ligjore , si dhe OBP akoma nuk e publikuar në sistem.

Në këto kushte, shtesa e kontratës përbën zgjidhjen më proporcionale, urgjente dhe ligjërisht ejustifikuar, pa cenuar parimet e transparencës dhe konkurrencës.Në përfundim, Autoriteti Kontraktor konstaton se shtesa e kontratës është e mbështetur në rrethana objektive dhe të dokumentuara, respektohen kufijtë ligjorë të ndryshimit të kontratës si dhe garantohet vazhdimësia e një shërbimi jetik për të sëmuarit

Shtesa nuk cenon konkurrencën dhe nuk ndryshon kontratën në thelb,nuk ndryshohet objekti i kontratës,nuk ndryshohen çmimet njësi,nuk ndryshohen kushtet thelbësore,operatori ekonomik është i njëjti i përzgjedhur me procedurë konkurruese,shtesa është e kufizuar në vlerë ($\leq 20\%$) dhe në kohë.

10. Përshkrimi i modifikimit të Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

Me qëllim garantimin e vazhdimësisë se trajtimin dhe asgjësimin të mbetjeve të rrezikshme, deri në përfundimin e afatit te draft marrëveshjes kuadër si dhe finalizimin e procedurës së prokurimit të zhvilluar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara, është shtuar dhe vlera e draft marrëveshjes me vlere me: 2,270,400.00 (dy milionë e dyqind e shtatedhjete mijë e katerqind) Lekë pa TVSH.

Ne pergjigje te kerkeses tuaj ju inforjme se NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT behet per draft marrefeshjen kuadër për Draft marreveshje Nr 673 prot, dt 17.03.2025 me afat 12 muaj per Lot 2: Trajtim dhe asgjesimin I mbetjeve te rrezikshm me vlere me fond limit 11,352,000.00 (njembedhjete milion e treqind e pesedhjete e dy mije) leke pa tvsh.

Kontrate Nr 104 dt 09.01.2026 me fond 880,000.00 (teteqind e tetedhjete mije) leke pa tvsh Me afat levrime deri 16.03.2026, pamvarsisht afatit te kohezgjatjes se saj sasia e e kontraktuar ka perfunduar me date 26.01.2026.Pas dates 26.01.2026. Pas kesaj date te mbetjet e rrezikshme spitalore jane te ambalazhuara ne ambjentet spitalore.

Ne pergjigje te refuzimit tuaj ju njoftojme se Urdher prokurimi Nr 52 dt 12.11.2024 protokolluar me Nr 2948 prot, dt 12.11.2024 me objekt:

Trajtimin dhe asgjesimin e mbetjeve spitalore e ndare ne lote me fond limit: Lot 2 :Trajtim dhe asgjesimin I mbetjeve te rrezikshme me fond limit 11,352,000.00(njembedhjete milion e treqind e pesedhjete e dy mije) leke pa tvsh, si dhe vlere për Draft marreveshje Nr 673 prot, dt 17.03.2025 me afat 12 muaj per Lot 2: Trajtim dhe asgjesimin I mbetjeve te rrezikshm me vlere me fond limit 11,352,000.00 (njembedhjete milion e treqind e pesedhjete e dy mije) leke pa tvsh, pra eshte ezauruar plotesisht fondi.

Spitali Rajonal Shkoder ka pasur nje rritje te aktivitetit spitalor krahasim me vitet e meparshme ,me rritjen e semundeshmerise , shtrimet, operacionet qe kane cuar mbarimin e sasiseve te kg para mbarimit te marrevshjes kuader.

Jemi ne nje suate kritike pasi mbetjet e rrezikshme spitalore jane te ambalazhuara ne ambjentet spitalore

Ky modifikim nuk ndryshon objektin, kushtet thelbësore apo balancën ekonomike të kontratës dhe realizohet në përputhje të plotë me nenin 127 pika 1 shkronja “c” dhe pika 2 të ligjit për prokurimin publik.

11.Vlera totale e marrëveshjes kuadër së nënshkruar: 11,352,000.00 (njembedhjetemilion e treqind e pesedhjete e dymijë) leke pa tvsh.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 11,352,000.00 (vlera aktuale) +2,270,400.00 = 13,622,400.00 (trembedhjetemilion e gjashtëqind e njezete e dymijë e katerqind) leke pa tvsh

13. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:12 muaj nga neshkrimi i draft marrveshjes
Dhe afati i ri (nëse është rasti): nuk ndryshon

14. Emri dhe adresa e Operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri: ECO RICIKLIM SH.P.K

NIPT: L61814009B

Adresa : Elbasan,Metalurgji, Bradashesh, Pasuria Nr.1070, Zona Kadstrale 3965,Elbasan,.

15.Data e nënshkrimit të modifikimit :03.02.2026

16.Burimi i financimit: Buxheti i shtetit

17.Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor